



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 5 , Datë 20.05.2013

Për

Miratimin e projekt-idesë për "Rehabilitimin e disa digave ekzistuese të rezervuarëve për vaditje".

Në zbatim të pikës dh. neni 4. kreu II. të ligjit nr.8681. datë 02.11.2000. "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përherëshëm i Digave (KTPD), me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.1798 prot. datë 16.04.2013 në mbledhjen e datës 17.05.2013, mori në shqyrtim projekt-idenë për "Rehabilitimin e digave ekzistuese të rezervuarëve Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë ", nga projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.

Mbasi u prezantua projekt-ideja nga përfaqësuesit e grupit të projektimit Mott MacDonald në datë 17.05.2013 si dhe diskutimi nga anëtarët e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha,

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë për "Rehabilitimin e digave ekzistuese të rezervuarëve Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë ".

Me respekt,

PERKËDISHNICA
KRYETAR